

KËRKIME GJUHËSORE

Manjola ZAÇELLARI

MENDËSIA SHQIPTARE TE FRAZELOGJIA ME FJALËN SY

Pjesa dërmuese e frazeologjisë së shqipes është parë si krijim kryesisht popullor e historik e si e tillë ajo mbart tregues të psikologjisë e të mendësisë së popullit tonë, të historisë e të kulturës së tij.

Dihen tashmë vlerat e njësisë frazeologjike, ajo sjell pasurim e zgjerim të mjeteve të shprehjes, por edhe vlera më të mëdha në përmbajtje e në ngjyrimin emocionues, sjell nuanca të holla kuptimesh e përdorimesh, gjykimin e popullit për gjërat e për njerëzit¹. Frazelogjia e zbukuron ligjërimin e përdoruesit të një gjuhe, qoftë në atë të thjeshtë, atë bisedor apo atë artistik. Shqipja, e krahasuar me gjuhët e tjera, është shumë e pasur me njësi frazeologjike dhe me një traditë frazeografike të vlerësueshme². Meqenëse frazeologjia spikat për shprehësinë, ajo është e lidhur ngushtë me shpirtin e njeriut. “Rezervat” frazeologjike të një gjuhe janë burimi i një dijeje rreth kulturës dhe mendësisë së njerëzve. Ne mund të zbulojmë se njësitë frazeologjike përmbajnë informacion rreth ideve të njerëzve, jetës, zakoneve, ritualeve, moralit, sjelljes, kulturës, historisë, ndërgjegjes etj. Ato mund të japin informacion rreth tipareve karakteristike të njerëzve, të grupeve, por edhe të etnive të caktuara.

Frazelogjia krijohet nga shndërrimi i figurshëm i sintagmave të lira; nga një sintagmë që lidhet me një ngjarje, nga formime analogjike si: (*shes mend*) etj.

Burimet e krijimit të njësive frazeologjike janë të ndryshme. Ato janë me burim vendës, por mund të kenë hyrë edhe nga një gjuhë tjetër, kur e ka kërkuar një stil i caktuar.

Ka studiues që frazeologjinë e shohin si atë fushë të studimeve gjuhësore që shpreh lidhjen mes gjuhës e kulturës në një shkallë më të lartë³. Kjo për arsye se njësitë frazeologjike lidhen me imazhe, tradita, zakone, të cilat janë karakteristike për kultura, për kohë dhe për zhvillime të caktuara.

Sot studimet për frazeologjinë nuk mbeten brenda rrafshit semantik dhe strukturor. Teoria frazeologjike po merr në konsideratë arsyen pse informacioni kulturor duhet të përfshihet brenda kuptimit gjuhësor. Kështu, “ajo mund të vështrohet si një hapësirë ku mund të testohen paradigmat antropomorfike në gjuhë. Frazemat nuk janë thjesht njësi të sistemit shënjor, gjuhës, por ato janë

¹ J. Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2006, f. 238.

² V. Memisha, Studime për fjalën shqipe, Tiranë, 2011, f. 81.

³ A. P. Cowe, Phraseology Theory, Analysis and Applications, New York, 1998, f. 54-56, Jean-Pierre Colson, Cross-linguistic phraseological, fq. 193, Elisabeth Pirainen, Figurative phraseology and culture në Phraseology, an interdisciplinary perspective, Berlin, 2007, f. 207.

bartëse të kulturës duke nxjerrë në pah nevojën për kërkime moderne frazeologjike duke u mbështetur tek kultura”⁴.

Në këtë punim është marrë në shqyrtim grupi paradigmatic i njësive të motivuara me fjalën *sy*⁵ siç mund të merrej edhe grupi paradigmatic i fjalës *zemër*, *kokë*, *gjak*, *dorë* etj., sepse te njësitë që bëjnë pjesë në këtë grup mund të zbulosh të gjitha dukuritë, të rrafshit të përmbajtjes, të formës dhe të funksionit.

Kështu njësi të tilla si: *e hëngri me sy*, *e përpiu me sy*, *e mori mësysh*; *prish syrin e keq*; *syri i lig*, *e ka me sy të keq*; *ka sy të lig (të keq)*; *e ka me sy të mirë (dikë)* shprehin besëtytni, paganizëm dhe myslimanizëm. *E hodhi (e vuri) festen (kësulën, qeleshen, kapelën, takijen) mbi sy*; *e hodhi (e vuri) festen (kësulën, qeleshen, kapelën, takijen) mënjanë*; *kullot sytë* vijnë nga bota e fshatit, *si e ke syrin e pushkës?* lidhet me historinë, etj.

Prof. J. Thomai thotë se “karakteri popullor i frazeologjisë së shqipes duket edhe në gjymtyrët përbërëse të njësive frazeologjike. Mjaft njësi frazeologjike ndërtohen me fjalë që shënojnë pjesë të trupit: *dorë*, *faqe*, *këmbë*, *krah*, *lëkurë*, *sy*, *shpinë*, *vesh*...; me fjalë që shënojnë sende, të cilat e rrethojnë përditë njeriun: *çati*, *derë*, *lugë*, *pjatë*, *prag*, *shkop*...; me fjalë që shënojnë bimë e kafshë: *dhi*, *ferrë*, *gomar*, *gjel*, *lakër*, *lule*, *mushkë*, *presh*, *lule*, *qen*...; me foljet më të zakonshme: *bëj*, *dal*, *heq*, *hyj*, *kam*, *kap*, *shkoj*, *shoh*, *vë*...”⁶.

Në mendësinë e shqipfolësve fjala *sy* është njëherësh e lidhur me emocionet, dashurinë, mundësinë, punën, urrejtjen, ironinë, sarkazmën etj. Në çdo moment populli shqiptar ka krijuar fjalë a njësi për t’u shprehur sa më mirë. “Gjatë gjithë qenësisë së vet, populli ynë ka mbajtur një qëndrim të caktuar ndaj gjuhës, duke e parë kurdoherë atë në lidhje organike me vetëdijen etnike, duke zbatuar përherë një politikë gjuhësore, e cila gjithnjë e më shumë është rrënjësuar në mendjet e zemrat e njerëzve”⁷.

Ne jemi mbështetur të njësitë frazeologjike që gjenden te Fjalori Frazeologjik i Gjuhës Shqipe i hartuar nga Akademik Jani Thomai, botim i vitit 2009. Ky Fjalor përfshin një korpus frazeologjik me rreth 10.000 njësi të përdorshme gjerësisht, me rreth 30 000 shembuj të shkurtër nga shumë burime (ligjërimi i folur popullor, folklori, letërsia artistike shqipe dhe e përkthyer, publicistika etj), me vargje sinonimike të pasura dhe me ndarje kuptimore e me shpjegime të plota për kuptimet e përdorimet.

Në këtë mënyrë ne mund të bëjmë dy ndarje të mëdha:

- njësi frazeologjike të motivuara me fjalën *sy* që lidhen me botën materiale dhe
- njësi frazeologjike të motivuara me fjalën *sy* që lidhen me botën shpirtërore, intelektuale, estetike etj.

⁴ Elisabeth Pirainen, *Figurative phraseology and culture* në *Phraseology, an interdisciplinary perspective*, Berlin, 2007, f. 207.

⁵ Shembujt janë nxjerrë nga Fjalori Frazeologjik i Gjuhës Shqipe, J. Thomai, Tiranë, 2006.

⁶ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 238.

⁷ Gj. Shkurtaç, *Sociolinguistika*, Tiranë, 2003, f. 68-69.

MENDËSIA SHQIPTARE TE FRAZELOGJIA ME FJALËN SY

Brenda secilit grup janë bërë grupime taksonomike, duke zbuluar fusha konceptore nga më interesantet, nga më të larmishmet, si fusha që shprehin:

- dashuri (*e kam*) *si dy sytë*, (*e ruaj*, *e dua*) *si sytë e ballit*, si dritën e syrit (*syve*); *e kam dritë në sy*; (*e kam*) *si dy sytë*; *e kam sy në ballë*; si syrin e vetëm;
- mençuri (është) *për t'i qitur* (*për t'i nxjerrë*) *sytë* (dikush) është shumë i zgjuar e ta hedh; *ka katër sy* (dikush);
- urim *mos të qaftë syri* (*kurrë*).

Fusha që lidhen me:

- betimet *pash sytë e ballit!*, *për sytë e ballit!*, *më plaçin sytë!*;
- me punën *ç'i sheh syri ia bën dora*;

fusha që shprehin:

- mallkim të *zëntë sytë* (*buka*)!, *t'u thafshin sytë!*;
- urrejtje *nuk dua t'ia shoh sytë* (*dikujt*), *nuk e shoh dot me sy* (*dikë*); (*e dua*) *si kripën në sy*, *nuk e shoh dot me sy*, *e kam halë në sy*, *më dhembin sytë*, *nuk dua t'ia shoh sytë*;
- ironi *për sytë e bukur* (të dikujt), *e sheh me sytë e bufit* (*dikë a diçka*), *i ktheu sytë nga dielli*;
- përbuzje *më mbiu në sy* (dikush a diçka); *e kam halë në sy*, *më dhembin sytë* etj.

Në një prerje tjetër janë parë edhe fushat konceptore që lidhen me mendësinë burimore:

- me origjinë nga bota e kafshëve (shpendëve, insekteve), p.sh. *si sytë e dhisë në hell*; *e sheh me sytë e bufit*; *i kërkon pleshtit syrin*; *fle me një sy hapur*; *gjithë sy veshë* etj.
- nga bota njerëzore, p.sh. *si dritën e syve*, (*e ruaj*) *si synë e vetëm*, (*e kam*) *si dy sytë*; *si sytë e ballit* etj.

Njësitë frazeologjike të motivuara me fjalën sy përdoren në ligjërimin e thjeshtë, bisedor dhe në atë të lartë.

- “Ligjërimi i thjeshtë ka të bëjë me ligjërimin e përditshëm të njerëzve të profesioneve e të krahinave të ndryshme, që nuk i përmbahen në të folur normës gjuhësore, e shkelin ose e shtrembërojnë atë”⁸. Njësi të tilla të motivuara me fjalën sy ka shumë si: *bie në sy*; *më ra në sy*; *nuk i dal në sy*, *më bëjnë sytë*, *ma bën me sy*; *bëra një sy gjumë*, *më ranë sytë*; *ma ha syri*; *ia hap syrin*; *nuk ia hedh sytë*; *nuk ka sy*; *s'ka sy e faqe*; *të merr sytë*; *m'u ngop syri*; *nxjerr sytë*; *më plaçin sytë!*; *i qan syri*; *sa për sy e faqe*; *me syrin xixë*; *nuk e shoh dot me sy*; *ta thotë në sy*; *iu çapëlyen sytë*; *nuk dua t'ia shoh sytë*; *i faksin sytë*; *fërkoj sytë*; *fryj sytë*; *ia hëngri sytë*; *i ha syri në qime*; *hiqmu* (shporrmu) *nga sytë* (sysh)!; *më ikën* (më lanë) *sytë*; *më iku nga sytë*; *i kërkon pleshtit syrin*; *s'ka sy e faqe*; *më kulluan sytë*; *kullot sytë*; (*sa*) *pa larë sytë*; *m'u mbush syri*; *m'u ngop syri*; *ia nguli sytë*; *ia ngjiti sytë*; *m'u nxinë sytë*; *më ka shkarë syri*; *e kam halë në sy*; *nuk ia shtie sytë*; *më thau sytë*; *më therin sytë*; *ma zuri syri* etj.

- Ligjërimi bisedor afrohet me ligjërimin e thjeshtë, se edhe këtu kemi lëkundje të normës gjuhësore. “Ligjërimi bisedor është, si të thuash, varianti që merr standardi

⁸ J. Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2006, f. 294.

kur përdoret në të folur e në biseda të lira, ku norma nuk ndihet si prangë e nuk ruhet plotësisht, por u nënshtrohet ndryshimeve që kërkojnë rrethanat e fushat e marrëveshjes gjuhësore, formimi kulturor i folësit, vetë lloji i ligjërit (i shkruar a i folur) ose synimet stilistike⁹, si: *iu çelën sytë; nuk i jap sy; mbyll një sy; shëtit sytë; i shkëlqejnë sytë; më ka shkuar syri; e shoh me një sy tjetër; s'i trembet syri; i zuri sytë; m'u zvogëluar sytë* etj.

c. Ndërsa në ligjërimin libror norma gjuhësore ruhet me kujdes dhe çdo shkelje e saj ndihet menjëherë¹⁰, si: *iu hapën sytë; e ka syrin (i ka sytë) (te dikush a te diçka); drejton syrin; e bën një sy të verbër; mpreh sytë; me sytë e mendjes; me sytë e zemrës; i shkrepitjën (flakërojnë) sytë; iu shuan sytë; m'u verbuan sytë; e verbon një sy; më ra në sy* etj.

Në gjuhën shqipe njësitë frazeologjike mund të kenë strukturë togfjalëshi ose strukturë fjalie.

Njësitë frazeologjike me fjalën *sy* me strukturë togfjalëshi janë më të shumta në numër. Ato mund të jenë formime emër + emër *për sytë e ballit; me sytë e zemrës; sy për sy; me sytë e mendjes* etj.

Emër + mbiemër *për sytë e bukur; syri i keq* etj.

Folje + emër *bie në sy; drejtoj sytë; i faksin sytë; hap sytë; ka katër sy; të kënaqet syri; laj sytë; mpreh sytë; shëtit sytë; shtroj syrin; të vret sytë; zbardhi sytë; m'u veshën sytë* etj. Njësitë frazeologjike me fjalën *sy* të formuara nga një folje dhe një emër zënë vëllim më të madh.

Disa njësi frazeologjike të motivuara me fjalën *sy* kanë kaluar në fjali pyetëse *Ku i ke sytë?*, dëshirore kur shprehet një urim *mos të qaftë syri (kurrë)*, a një mallkim *të zëntë sytë (buka)!*, *t'u thafshin sytë!* dhe më rrallë në dëftore *(le) të nxjerrë sytë*. Këto njësi janë më të pakta dhe përbëhen zakonisht nga dy gjymtyrë: *iu njomën sytë; (I) perëndoi (fali) sytë; i përshkënditin sytë; Më plaçin sytë!; Të plaçin sytë!; I qan syri; lu shuan sytë; m'u verbuan sytë; i vetëtini syri; ma zuri syri; m'u zvogëluar sytë* etj.

Pjesa më e madhe e njësive frazeologjike kanë burim vendës. Ato janë krijime brenda ligjëtimeve popullore që kanë lindur dhe janë përpunuar në gjuhën e folur. Por në faza të ndryshme të zhvillimit të saj, shqipja, ka huazuar njësi frazeologjike kur e ka kërkuar një stil i caktuar si: *honoris causa, modus vivendi* etj.

Këto huazime i nënshtrohen një vlerësimi shoqëror e kulturor prej të cilit mbeten ngjyrimet stilistike në leksik dhe, rrjedhimisht, mund të shfrytëzohen po për ato synime dhe me po ato përftesa shprehëse¹¹.

Një vend pak më të madh zënë njësitë e huazuara si kalke, apo thënë ndryshe huazimet strukturore (kur fjala në të vërtetë është shqip, por është ndërtuar sipas gjedhes së një fjale të huaj) *thyej akullin, vë pikën mbi i* etj.

⁹ J. Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2006, f. 294.

¹⁰ J. Thomai, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë, 2006, f. 294.

¹¹ Xh. Lloshi, Stilistika e gjuhës shqipe dhe Pragmatika, Tiranë, 2001, f. 114.

MENDËSIA SHQIPTARE TE FRAZELOGJIA ME FJALËN SY

Ne kemi parë se njësitë frazeologjike me fjalën sy që kemi marrë në shqyrtim kanë më së shumti burim vendës, si: *ia bën me sy, më ra në sy, sa çel e mbyll sytë, të gënjen syri, s'ma ha syri, hap sytë!, i hedh një sy, i hap sytë, hiqmu sysh, mos i jep sy!, e ka halë në sy, s'ka sy e faqe, s'ma mbush syrin, më mbetën sytë (në të), mbylli sytë (vdiq), mbylli një sy, i nguli sytë, s'më punojnë sytë, (ruaj) si syt e ballit, për sy të botës, sa për sy e faqe, me sy të mirë, sy ndër sy, i shkeli synë, s'i trembet syri, vë festen mbi sy, ia ka vëne synë, më vret sytë, nuk ma zuri syri.*

Ka dhe njësi frazeologjike me fjalën sy të huazuara si kalke si: *hedh sytë; i hodhi një sy; nuk ia hedh sytë; drejtoj sytë; kthej sytë* etj.

Këto njësi përdoren kryesisht pa ngjyrim emocionues dhe për qëllime të caktuara në fusha të tilla si në atë të shkencës, në publicistikë etj.

* * *

Siç u pa, mjafton vetëm një grup paradigmatic njësisht frazeologjike, si ai me fjalën sy që të vëresh një problematikë të tërë, një tërësi dukurish interesante që zbulojnë gati të gjitha fushat studimore gjuhësore.

Ne po punojmë për t'i parë në përgjithësi te gjithë frazeologjia e shqipes këto specifika.

BIBLIOGRAFI

Elisabeth Pirainen, *Figurative phraseology and culture në Phraseology, an interdisciplinary perspective*, Berlin, 2007.

Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe, Tiranë, 2010

Fjalor i Gjuhës Shqipe, Tiranë, 2006.

Gj. Shkurtaj, *Sociolinguistika*, Tiranë, 2003.

J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.

Jean-Pierre Colson, *Cross-linguistic phraseological studies në Phraseology, an interdisciplinary perspective*, Berlin, 2007.

P. Cowie, *Phraseology Theory, Analysis and Applications*, New York, 1998

V. Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, Tiranë, 2011.

Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe Pragmatika*, Tiranë, 2001.